

DREJT NJË KOMUNITETI TË QËNDRUESHËM



PLANI VJETOR I SHKOLLËS SË MESME “DOM NIKOLLË KAÇORRI”,

DURRËS 2019-2020

HARTUAR MBI MODELIN E SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE

PLANI VJETOR I SHKOLLËS SË MESME “DOM NIKOLLË KAÇORRI”, DURRËS 2019

“DREJT NJË KOMUNITETI TË QËNDRUESHËM”

STANDARDET DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

STANDARDI 1- SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

PËRSHKRIM I STANDARDIT: Shkolla, bashkëpunon me prindërit dhe partnerë të tjerë të komunitetit për të njohur, adresuar dhe përmbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Ato, së bashku, ofrojnë programe (që përfshijnë veprimtari fizike, e sportive, programe për të ushqyerin e shëndetshëm, veprimtari kulturore etj.) të cilat kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të klimës në shkollë.

Objektivat specifikë:

- Mbështetje dhe zhvillim social, emocional dhe shëndetësor për nxënësit e shkollës së mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës
- Ndërtim i mekanizmave të referimit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
- Ofrim i mjediseve të sigurta të të nxënësve, të cilat garantojnë mirëqënien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve

STANDARDI 2- ANGAZHIM DHE ZHVILLIM I KOMUNITETIT

PËRSHKRIM I STANDARDIT: Shkolla ofron shërbime që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit, dhe komuniteti është pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkollë. Në këtë mënyrë nuk përfton vetëm komuniteti nga shkolla por dhe shkolla bashkëpunon me komunitetin për rritjen dhe përmirësimin e rezultateve për nxënësit.

Objektivat specifikë:

- Pjesëmarrje aktive e prindërve në vendimmarrjen në shkollë dhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme

- Zhvillim i kurseve profesionale, aktiviteteve dhe trajnimeve për komunitetin, të rinjtë dhe grupet vulnerabël.
- Sigurim i kapaciteteve të duhura njerëzore dhe kushteve të duhura fizike për të siguruar zbatimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK

STANDARDI 3: VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT

PËRSHKRIM I STANDARDIT: Prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimmarrjet që ndikojnë në cilësinë e shkollës dhe arrijtjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe krijojnë politika, praktika dhe programe në dobi të suksesit të nxënësve.

Objektiva specifike

- Hartim i planeve strategjike dhe vjetore të shkollës me përfshirjen e prindërve, komunitetit dhe institucioneve shtetërore vendore.
- Informim i shpeshtë i komunitetit, dhe institucioneve vendore mbi shërbimet dhe aktivitetet që ofron institucioni arsimor.

STANDARDI 4: GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

PËRSHKRIMI I STANDARDIT: Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave shoqërore si dhe të bashkëjetesës në shoqëri.

Objektiva specifike:

Mësuesit, prindërit dhe aktorë të tjerë të komunitetit sigurojnë që shkolla ofron trajtim të barabartë, me dinjitet dhe respekt ndaj çdo nxënësi.

Ofrim i mundësive të barabarta për t'u regjistruar në shkollë, për ta ndjekur dhe përfunduar atë. Ndërtim i programeve dhe zbatim i projekteve të vazhdueshme që nxisin gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.

STANDARDI 1: SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE						
OBJEKTIVA SPECIFIKË:						
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetje dhe zhvillim social, emocional dhe shëndetësor për nxënësit e shkollës së mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës ➤ Ndërtim i mekanizmave të referimit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. ➤ Ofrim i mjediseve të sigurta të të nxënit, të cilat garantojnë mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve 						
AKTIVITETI	AKTORËT PËRFSHIRË	INSTITUCIONI / ORGANI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	PERIUDHA	Indikatori matës	TREGUESI i SYNUAR DERI NË QERSHOR 2020	Burimi i financimit
<i>Takime diskutuese</i> ndërmjet prindërve, mësuesve dhe psikologut/ punonjësit social të shkollës mbi rolin e shërbimit psiko-social ndaj nxënësve dhe thyerjen e “tabu-ve” mbi marrëdhënien individ-psikolog.	Psikologu i shkollës Prindër Stafi pedagogjik	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës ZVA Durrës Bordi i prindërve	Janar-Qershor 2020	Numri i takimeve të organizuara. Numri i prindërve pjesëmarrës. Numri i rasteve të diskutuara nga prindër të vëçantë dhe të trajtuara nga psikologu.	6 takime Min. 100 prindër	N/A
<i>Takime ndërgjegjësuese</i> mes psikologut të shkollës dhe nxënësve të të gjitha klasave mbi rëndësinë e bashkëpunimit psikolog-nxënës.	Psikologu i shkollës Nxënësit	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës ZVA Durrës Bordi i prindërve Senati i nxënësve	Janar-Qershor 2020	Numri i takimeve të organizuara. Numri i nxënësve të cilët trajtojnë çështje/ probleme të tyre me psikologun. Numri i rasteve të marra në shqyrtim me psikologun dhe të zgjidhura në	Të përmuajshme me të gjitha klasat.	N/A

				bashkëpunim me prindërit		
Takime të hapura mes nxënësve, të rinjve të komunitetit dhe punonjësve të shërbimit shëndetësor mbi çështje të ndryshme të kujdesit shëndetësor. (Punonjësi i shërbimit shëndetësor mund të jetë dhe prind fëmije)	Nxënësit Punonjësi i shërbimit shëndetësor Prindërit Të rinj të komunitetit	Institucioni i shërbimit shëndetësor Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës ZVA Durrës Grupime rinore	Mars-Qershor 2020	Numri i takimeve dhe temave të trajtuara në to	6 takime 6 tema	N/A
Aktivitet i klubit sportiv me nxënës dhe të rinj të komunitetit dhe sigurimi i bazës materiale	Nxënësit Mësuesit Të rinj të komunitetit Prindërit dhe komuniteti të cilët kontribuojnë sipas mundësive në bazë materiale Bashkia Durrës e cila ndihmon për të siguruar bazën materiale	Shkolla e mesme Bashkia Durrës ZVA Durrës Biznesi vendas	Dhjetor 2019-qershor 2020	Numri i aktiviteteve të organizuara Plotësimi i nevojave materiale	2 takime në muaj	N/A
Ndeshje sportive ndërmjet nxënësve të shkollës dhe punonjësve të policisë Durrës						

Ndeshje sportive ndërmjet nxenesve të shkollës dhe punonjësve të bashkisë Durrës						
Veprimtari artistike nga nxënësit me tematikë kundër bullizmit/diskriminimit	Nxënës Prindër Anëtarë të komunitetit Të rinj të komunitetit	Shkolla e mesme ZVA Durrës Bashkia Durrës Prindërit	Prill – qershor 2020	Numri i veprimtarive aristitike	Minimalisht 3	N/A
Veprimtari sportive. Ndeshje sportive ndërmjet klubeve të shkollave të qytetit	Nxënës të shkollave të ndryshme Prindër Anëtarë të komunitetit Të rinj të komunitetit	Shkolla e mesme DRAP Durrës Bashkia Durrës Bordi i prindërve Organizata rinore	Mars – qershor 2020	Numri i ndeshjeve të realizuara Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti dhe të rinj	Min. 3 ndeshje Min. 30 anëtarë të komunitetit dhe nxënës të shkollës	N/A
Krijimi i klubit të multi-medias	Stafi pedagogjik, Qeveria e nxënësve Prindër Komunitet	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçori” Durrës Grupim rinor ZVA Durrës Bashkia Durrës	Janar 2020	Sallë kompjuterash me internet e disponueshme për të rinjtë e zonës e cila ka për qëllim edukimin/ndërgjegjësimi nëpërmjet internetit		IDM, Bashkia, bizneset
Trajnimi për edukimin ndaj Medias dhe Komunikimit	Qeveria e nxënësve IDM	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçori” Durrës	Janar – Maj 2020	Numri trajnimeve të mbajtura	Trajnime për nxënës të klasave të dhjeta.	IDM

Trajnimi i kodimit	IDM Qeveria e nxënësve	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçori” Durrës	Shkurt- Maj 2020	Numri i trajnimeve të mbajtura	Trajnime rreth kodimit, IT dhe programeve komputerike	IDM
<i>Takim informues, ndërgjegjësues i përfaqësuesve të komisariatit të policisë Durrës (specialist të policimit në komunitet+oficeri i sigurisë së shkollës) me nxënësit mbi substancat narkotike, duhanin, alkoolin, braktisjen e shkollës</i>	Nxënës Prindër Anëtarë të komunitetit Të rinj të komunitetit	Komisariati i policisë Durrës Shkolla e mesme Grupimi rinor	Janar- qershor 2020	Numri i takimeve të kryera Numri i pjesëmarrësve nxënës dhe të rinj të komunitetit	5 takime Ndërmjet takimeve të vërehet rritje e pjesëmarrjes së të rinjve.	N/A
Takim ndërmjet nxënësve, të rinjve të komunitetit dhe përfaqësuesve të bashkisë Durrës mbi qytetarinë aktive	Nxënës, të rinj të qytetit	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri” Grupimi rinor Bashkia Durrës	Mars- qershor 2020	Numri i takimeve të kryera Numri i pjesëmarrësve nxënës dhe të rinj të komunitetit.	5 takime Ndërmjet takimeve të vërehet rritje e pjesëmarrjes së të rinjve.	N/A
Takim ndërmjet nxënësve, të rinjve të komunitetit dhe përfaqësuesve të komisariatit të policisë Durrës mbi menaxhimin e situatave problematike dhe	Nxënës, të rinj të qytetit	Komisariati i policisë Durrës Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”	Janar- qershor 2020	Numri i takimeve të kryera Numri i pjesëmarrësve nxënës dhe të rinj të komunitetit	5 takime Ndërmjet takimeve të vërehet rritje e pjesëmarrjes së të rinjve.	N/A

raportimin e tyre në organet kompetente		Grupimi rinor				
Vendosja e një kutie raportimi në ambientin e shkollës për raportimin e dhunës, situatave problematike, rasteve të diskriminimit, etj.	Nxënës Mësues Oficeri i sigurise, IDM	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri” Qeveria e Nxënësve Psikologu/punon jësi social i shkollës Oficeri i policisë së shkollës	Dhjetor 2020			
STANDARTI 2: ANGAZHIMI DHE ZHVILLIMI I KOMUNITETIT						
OBJEKTIVA SPECIFIKË:						
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesëmarrje aktive e prindërve në vendimmarrjen në shkollë dhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme ➤ Zhvillim i kurseve profesionale, aktiviteteve dhe trajnimeve për komunitetin, të rinjtë dhe grupet vulnerabël. ➤ Sigurim i kapaciteteve të duhura njerëzore dhe kushteve të duhura fizike për të siguruar zbatimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK 						
AKTIVITETI	AKTORËT PËRFSHIRË	INSTITUCIONI / ORGANI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	PERIUDHA	INDIKATORI MATËS	TREGUESI I SYNUAR DERI NË QERSHOR 2020	Burimi i financimit
Takime të vazhdueshme mësues-nxënës-prindër për të bërë të mundur që prindërit të jenë sa më afër shkollës, në mënyrë që të	Stafi pedagogjik, nxënësit, prindërit	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Bordi i prindërve,	Janar 2020 në vazhdim	Numri i takimeve të organizuarra, numri i prindërve/nxënësve pjesëmarrës	Min. 4 takime Shkolla sigurohet që në këto takime kanë marrë pjesë të gjithë prindërit.	N/A

ideohen planet e rritjes së performancës së nxënësve		Qeveria Nxënësve				
Pasurimi i bibliotekës së shkollës, e disponueshme për të gjithë komunitetin, gjithashtu vënia në dispozicion e një klasë që do ketë funksion multifunksional	Gjithë komuniteti IDM	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”, Bashkia, DRAP Durrës; Grupime rinor	Dhjetor 2019- qershor 2020	Numri i librave të shtuar fondit të bibliotekës Numri i qytetarëve që frekuentojnë bibliotekën		Shkolla, Bashkia, Shoqata e botuesve Shqiptarë, IDm
STANDARDI 3: VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT						
<i>Objektiva specifike</i>						
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartim i planeve strategjike dhe vjetore të shkollës me përfshirjen e prindërve, komunitetit dhe institucioneve shtetërore vendore. ➤ Informim i shpeshtë i komunitetit dhe institucioneve vendore mbi shërbimet dhe aktivitetet që ofron institucioni arsimor. 						
AKTIVITETI	AKTORËT PËRFSHIRË	INSTITUCIONI / ORGANI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	PERIUDHA	Indikatori matës	TREGUESI I SYNUAR DERI NË QERSHOR 2020	Burimi I financimit
Rishikim i planit afatmesëm strategjik të shkollës “Dom Nikollë Kaçorri” për vitin 2020-2022	Prindër, Mësues, Nxënës, Përfaqësues të institucioneve shtetërore vendore Komuniteti ZVA Durrës	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”	Prill-qershor 2020	Numri i pjesëmarrësve nga të gjithë aktorët vendorë	Plani strategjik i përfunduar Të gjithë aktorët e synuar të përfshirë në hartimin e këtij plani	N/A
Vlerësim i nivelit të zbatimit të aktiviteteve të planit vjetor 2019-2020 me pjesëmarrjen dhe kontributin e gjithë aktorëve vendorë	Nxënësit Mësuesit Të rinj të komunitetit Bashkia Durrës ZVA Durrës		Qershor 2020	Numri i pjesëmarrësve nga të gjithë aktorët vendorë	2 takime Të gjithë aktorët e synuar	N/A

	Komisariati i policisë Durrës Përfaqësues të OJF-ve të tjera			Rezultate të nxjerra nga takimet dhe analiza e zbatimit të aktiviteteve	Plani vjetor SHQK për vitin 2020 I rishikuar Numri i çështjeve /aktiviteteve të marra parasysh për zgjidhje/ mbështetje nga Bashkia dhe institucione të tjera përveç shkollës	
Krijimi i faqes elektronike të shkollës dhe përditësimi i vazhdueshëm për të qenë sa më informuese për çdo veprimtari në kuadër të SHQK, projekteve shkollore dhe jashtëshkollore.	Mësuesit, Bashkia, IDM	Shkolla e mesme “Dom Nikollë Kaçorri”		Numri i njoftimeve të publikuara	Rritja e angazhimit, ritja e pjesëmarrjes	N/A
Takime ndërmjet policisë- prindërve-mësuesve për konsolidim/ nxitje e marrëdhënies tre-palëshe mbi qëndresën komunitare dhe policimin në komunitet	Shkolla e mesme Bashkia Komisariati i policisë Komuniteti Bordi i prindërve	Komisariati i policisë Bashkia Shkolla e mesme (mësues, prindër)	Janar – qershor 2020	Numri i takimeve të mbajtura. 3-5 takime në 6 muaj	Rritja e ndërveprimit midis prindërve, shkollës, komuniteti dhe policisë	N/A

STANDARDI 4: GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

Objektiva specifike:

- Mësuesit, prindërit dhe aktorë të tjerë të komunitetit sigurojnë që shkolla ofron trajtim të barabartë, me dinjitet dhe respekt ndaj cdo nxënësi
- Ofrim i mundësive të barabarta për t’u regjistruar në shkollë, për ta ndjekur dhe përfunduar atë.

➤ Ndërtim i programeve, takimeve ndërgjegjësuere të vazhdueshme që nxisin gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.						
AKTIVITETI	AKTORËT PËRFSHIRË	INSTITUCIONI / ORGANI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	PERIUDHA	Indikatori matës	TREGUESI I SYNUAR DERI NË QERSHOR 2020	Burimi i financimit
Takime diskutuese midis stafit akademik, psikologut, sociologut dhe prindërve, mbi respektimin e dallimeve, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit	Mësuesit, psikologu, sociologu, prindërit	Shkolla e mesme Bordi i prindërve Grupimi i të rinjve	Janar – qershor 2020	Numri i takimeve Numri i pjesëmarrësve nga të gjithë aktorët e përfshirë në to	Nr. i takimeve: 3 Ndërmjet takimeve të vërehet rritje e interesit të aktorëve vendorë për të marrë pjesë në to.	N/A
Organizimi i panairit të diversitetit, me qëllim promovimin i harmonisë ndër-etnike dhe ndër-fetare	Mësues, Përfaqësues të Përfaqës, Përfaqësues të OJF-ve, Përfaqësues të komuniteteve fetare Komuniteti Nxënës	Shkolla e mesme, Bashkia, Grupimi rinore	Maj 2020			Biznesi lokal Prindërit Komuniteti Donatorë të tjerë të mundshëm
Aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese për fenomene negative në bashkëpunim me institucionet ligj-zbatuese dhe komunitetet fetare	Nxënës Prindër Mësues Komuniteti Të rinj dhe grupe vulneraber	Shkolla e Mesme “Dom Nikollë Kaçorri” Komunitetet fetare vendore Komisariati i Policisë	Shkurt – qershor 2020	Numri i takimeve dhe temave të trajtuara Numri i pjesëmarrësve	2 Takime të përmuajshme me prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të komunitetit me tematika të ndryshme të nxjerra gjatë takimeve me prindër nga ana komisarariatit të Policisë apo dhe nga	N/A

					<p>takime të oficerit të sigurisë në shkollë</p> <p>3 Takime mes përfaqësuesve të komuniteteve fetare dhe komunitetit mbi çështje që adresojnë bashkëjetesën fetare, parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare.</p> <p>Ndërmjet takimeve të vërehet rritje e interesit të aktorëve vendorë për të marrë pjesë në to.</p>	
Aktivitete ndërgjegjësuese nga të rinjtë për publikun kundër diskriminimit dhe paragjytimeve	Të gjithë aktorët vendorë	Qeveria e nxënësve Grupime rinore	Janar-qershor 2020	Numri i aktiviteteve që do të përmbajë kjo fushatë ndërgjegjësuese Numri i qytetarëve të përfshirë	4 aktivitete (si. Psh: teatër, diskutime publike, fushata ndërmjet shkollave, etj) 1500 qytetarë	